



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME INDUSTRIALE " ARBEN BROCI" SHKODËR

Nr. 32 Prot

Data 26 / 10 / 2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Udhëzimit nr 14, datë 27.05.2021. "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Ofruesi publik i AFP-së shkolla e Mesme Industriale " Arben Broci" Shkoder ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin Mesues i Praktikave Profesionale Drejtimi – Termohidraulike

- Pozicioni Mesues /Instruktur i Praktikave Profesionale; 1 pozicione pune.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së, për të cilin/cilat po aplikon;
- të ketë të ketë te paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në),
- kartën e identitetit;
- diplomën
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
 - l) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.
 - m) Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.
1. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 07.11.2023 (5 ditë pune nga publikimi i shpalljes).

DREJTORI

Zamir LAÇEJ

